



Buletini Mjedisor

21 MARS DITA E PYJEVE



Në 21 Mars, ditën ndërkombëtare të pyjeve, Ministri i Mjedisit z. Lefter

Koka zgjodhi një mënyrë ndryshe për të dhënë mesazhe për mbjelljen e pyjeve në vendin tonë. Ai zgjodhi që në këtë ditë të ishte pranë një biznesi, të cilin legjislacioni mjedisor i kërkon të mbjellë pemë në zonën ku ai zhvillon aktivitetin.

Kështu që në këtë ditë, në rrethin e Gramshit, z. Koka së bashku me Drejtorin e Projektit Hidroenergetik Devoll Hydro-power, Z. Ola By, dhanë një mesazh të gjitha bizneseve që zhvillohen në Shqipëri, për të kthyer vëmendjen e tyre dhe në mjedisin ku ata operojnë.

Kjo mbjellje zhvillohej edhe në kuadër të programit të ripëllëzimit, që kompania ka në planet e saj, si dhe bazuar në detyrimet ligjore me Qeverinë Shqiptare.

Ministri Koka shprehu rëndësinë që merr mesazhi që përcjell kjo ditë, për të rritur ndërgjegjësimin e publikut, bizneseve dhe institucioneve në të gjitha nivelet, në kontributin e tyre për ruajtjen dhe shtimin e

pyjeve për të balancuar ciklin e jetës në tokë. Ministri i Mjedisit shprehu kënaqësinë që në vendin tonë operojnë kompani të nivelit të Statkraft, të cilat aplikojnë standarde evropiane dhe kanë në fokus të misionit të tyre zbutjen e ndikimeve mjedisore dhe sociale që mund të ketë projekte, duke mundësuar një zhvillim të qëndrueshëm në zonë.

“Sot në Ditën Ndërkombëtare të Pyjeve gjetëm momentin të jemi pikërisht këtu, në Gramsh, në njërin nga aktivitetet, ku gjen zbatim koncepti “zhvillim i qëndrueshëm”. Kam kënaqësinë të shoh nga afër se si kjo kompani po respekton në mënyrën më të mirë legjislacionin mjedisor, për të ruajtur ekuilibrat e natyrës. Pëllëzimi ndihmon për të krijuar një mjedis të përshtatshëm për shumë kafshë e shpendë njëherësh, por gjithashtu ndihmon shumë në eliminimin e erozionit, një nga problemet që po shfaqet gjithmonë e më shumë në vendin tonë.” - theksoi Ministri Koka.

“Ne jemi shumë të kënaqur që Ministri Koka ka vizituar zonën tonë të projektit. Ripëllëzimi që po bëjmë është në të mirë të njerëzve

që punojnë rreth projektit, në të mirë të projektit, por patjetër edhe në të mirë të qeverisë shqiptare dhe të gjithë Shqipërisë” - tha z. By.

Programi i kompanisë për rigjenerimin e fondit pyjor parashikon të ripëllëzojë sipërfaqet e shpyllëzuara në Qarqet e Elbasanit dhe Korçës, si dhe zonat që janë prekur nga Projekti Hidroenergetik i Devollit nga ndërtimi i Hidrocentralit të Banjës dhe Hidrocentralit të Moglecës, ku në total është parashikuar që deri në fund të vitit 2017, do të mbillen 795 ha pyje të reja, nga të cilat 20 ha janë mbjellë deri tani.

Në këto 2 vite, qeveria shqiptare ka detyruar subjektet, që operojnë mbi fondin pyjor, si aktivitetet e HEC-eve, minierave dhe karrieraeve të gurit, që të zbatojnë ligjin për rehabilitimin e sipërfaqeve të marra në përdorim për shfrytëzim.

Shumë prej këtyre kompanive kanë tashmë dhe një marrëveshje me Ministrinë e Mjedisit, që të jenë edhe ata kontribues të asaj çfarë kanë dëmtuar, gjë që para 2013-ës nuk njihje si detyrim prej tyre.

KONFERENCA KOMBËTARE “MORATORIUMI DHE RRUGA DREJT ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM TË PYJEVE”



01.02.2016 - Ministria e Mjedisit zhvilloi Konferencën “Moratoriumi dhe rruga drejt zhvillimit të qëndrueshëm të pyjeve” në bashkëpunim me Universitetin Bujqësor të Tiranës.

Në këtë konferencë ishin ftuar 62 kryetarët e bashkive të vendit, për t'i njohur me reformat dhe legjislacionin e ri të Pyjeve, që është për miratim në Kuvendin e Shqipërisë.

Të pranishëm në këtë konferencë ishin Zëvendës Kryeministri, z. Niko Peleshi, Ministri i Mjedisit, z. Lefter Koka, kryetarët e bashkive apo përfaqësues të deleguar prej tyre, si dhe stafi akademik i Universitetit Bujqësor të Tiranës dhe Fakultetit të Shkencave të Natyrës, përfaqësues të shoqërisë civile, ekspertë mjedisorë, si edhe studentë.

Ministri Koka, pasi sollë në vëmendje reformat që janë ndërmarrë dhe janë në proces në fushën e pyjeve: si moratoriumi i pyjeve, por edhe projektligji i ri i pyjeve që pritet të miratohet së shpejtë, iu drejtua përfaqësuesve të pushtetit vendor, duke kërkuar prej tyre që të mendojnë më shumë për pyjet dhe mjedisin në tërësi:

“Investimi në mjedis shkon përtej 1 mandate”, - tha Ministri Koka. “Menaxhimi i pyjeve dhe mbetjeve duhet të jetë në prioritetin e përditshmërisë tuaj si Kryebashkiakë”.

Duke iu referuar situatës së trashëguar në mjedis, Ministri Koka theksoi se të gjithë duhet të

punojnë për të rikthyer besimin tek qytetarët. “Me universitetin dhe pushtetin vendor duhet të kemi një bashkëpunim të ngushtë për të rikthyer besimin tek qytetarët. Ligjet që bëjmë duhet të jenë të aplikueshme e të zbatueshme me qëllim ruajtjen e pyjeve në veçanti, por dhe mjedisit në tërësinë e tij” - u shpreh Ministri Koka.

Zëvendës Kryeministri, z. Niko Peleshi theksoi se ka ardhur koha që të mendohet më shumë për mjedisin: “Sot mjedisi është një çështje ndërkombëtare, ku e gjithë bota përballet me probleme të mëdha si problemi i ngrohjes globale etje. Por edhe Shqipëria përballet me probleme të mëdha siç janë përmbajtjet, erozioni probleme të cilat lidhen me situatën e pyjeve në vend. Në 10 vitet e fundit janë shtatërruar 200 mijë hektarë pyje dhe vetëm 260 hektarë janë pyllëzuar. Nëse do vazhdohej me këtë ritëm, për 10-15 vite do t'u linim fëmijëve tanë si trashëgim, një Shqipëri totalisht të zhveshur.

Ndaj duhet të bashkëpunojmë për çështje si mjedisi, pasi janë çështje, që politika nuk i zgjidh dot e vetme, pa ndihmën e të gjithë aktorëve. Është koha për të vendosur forcën e ligjit veçanërisht në fushën e pyjeve, por për këtë na duhet t'i besojmë forcës dhe përgjegjshmërisë së Kryetarëve të Bashkive, që do jenë administratorët kryesorë të kësaj pasurie natyrore” - tha z. Peleshi.

Në emër të përfaqësuesve të pushtetit vendor, kryetari i bashkisë së Kolonjës, z. Arben Malo

përhëndeti shpalljen e moratoriumit 10 vjeçar të pyjeve, si dhe përgatitjen e projektligjit të ri të pyjeve, duke sjellë vizionin e bashkisë së tij mbi politikat lokale mjedisore.

Konferenca vijoi me prezantimin e studimeve mbi gjendjen e trashëguar të pyjeve në vendin tonë, situatën aktuale, ndikimin pozitiv që pritet nga zbatimi i moratoriumit 10 vjeçar të pyjeve, etj.

Shefi i Departamentit të Pyjeve në Universitetin Bujqësor të Tiranës, Prof. As. Dr. Elvin Toromani hodhi tezat mbi strategjinë që duhet ndjekur për rigjenerimin e fondit pyjor në mbarë vendin.

Pasi bëri një pasqyrë të fakteve që çuan drejt shkatërrimit të sipërfaqes pyjore duke ndikuar edhe në florën dhe faunën shqiptare. Dekani i Fakultetit të Shkencave të Natyrës, z. Mynyr Koni vuri theksin në bashkëpunimin e ngushtë midis universitetit dhe Ministrisë së Mjedisit në fushën e pyjeve.

Përfaqësuesi i shoqërisë civile, ambientalisti Xhemal Mato në fjalën e tij theksoi suksesin e moratoriumit të gjuetisë duke vënë në pah edhe sfidën që sjell moratoriumi 10 vjeçar i pyjeve.

Të pranishmit në konferencë përshëndetën faktin se takimi mboldhi bashkë të gjithë aktorët, që kanë një rol të rëndësishëm si në studimin e hartimit e politikave, si në menaxhimin e pyjeve si një pasuri mjaft e rëndësishme natyrore, e cila sot realisht ndodhet në një moment mjaft kritik.

NË KËTË NUMER:

21 MARS DITA E PYJEVE—FQ 1

REZULTATË TË MONITORIMIT 2015—FQ2

LEJET MJEDISORE—FQ 3

RRJOHET ROJA E GJELBER—FQ3

“Misioni i Ministrisë së Mjedisit, është të hartojë dhe propozojë politika, strategji dhe plane veprimi për mbrojtjen dhe administrimin e mjedisit dhe pyjeve në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm, përmirësimit të cilësisë së jetës dhe të integritetit të vendit në Bashkimin Evropian. Përmesbushja e këtij misioni do të realizohet duke marrë pjesë, nxitur dhe bashkërenduar veprimtari, të cilat çojnë në zhvillime e mirëqenie afatgjata, duke mbrojtur natyrën dhe sensibilizuar opinionin publik”.

AGJENSIA KOMBËTARE E MJEDISIT: JA DISA REZULTATE TË MONITORIMIT 2015

Në zbatim të Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit (PKMM), Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) prezantoi rezultatet e nxjerra nga monitorimi i gjendjes së mjedisit për vitin 2015 në nivel kombëtar.

Në fjalën e tij kreu i AKM-së, Julian Beqiri theksoi se "Monitorimi i kryer gjatë vitit 2015 ka qënë një risi, pasi ka sjellë shtimin e stacioneve të monitorimeve, të të dhënave të mjedisit, si edhe janë rritur treguesit e të dhënave që monitorohen. Këtë vit, monitorimit të cilësisë së ajrit i shtohen dhe 98 stacione të reja, që llogaritet në një masë prej 12 % më shumë, krahasuar me dy vite më parë. Gjithashtu për vitin 2015 janë rritur dhe treguesit e monitorimit në masën 10%, krahasuar me periudhën 2013-2014" - u shpreh z. Beqiri.

Për herë të parë gjatë vitit 2015 është kryer monitorimi i cilësisë së ajrit përmes tubave difuz/pasiv, që realizohet

për të bërë shqyrtimin paraprak të nivelit të ndotjes në 42 pika në 18 qytete, që nuk mbulohej nga monitorimi sistematik deri tani.

Nga monitorimi i cilësisë së ujërave larës në dy detet tona gjatë vitit 2015 është vërejtur një rritje e cilësisë për ujrart larës, që Agjencia Kombëtare e Mjedisit monitoron në vite.

Kështu në këtë dalje për shtyp, drejtori i AKM-së deklaroi se: "Nga të dhënat e ardhura për monitorimin rezultojnë se ka një përmirësim të cilësisë së ujërave larës të plazheve tona, por gjatë vitit 2016-ës do të kemi një panoramë më të saktë të cilësisë së tyre, pasi numri i stacioneve monitoruese nga 78 ka arritur në 100. Kjo rritje e numrit të stacioneve do të ndihmojë jo vetëm strukturat mjedisore, por dhe pushtetin lokal të ndërhyjë aty ku është e nevojshme".

Gjatë vitit 2015 është vënë re rritje e numrit të stacioneve që monitoron ujërat me cilësi shumë të mirë me 45% ose me 35 stacione dhe ulje të numrit të stacioneve me cilësi shumë të keqe me 38% ose me 30 në vijim të krijimit të stacione monitorimi në vijën bregdetare.

Raporti vjetor tregon se liqenet kanë ruajtur të njëjtën cilësi, ndërsa vërehen ndryshime në cilësinë e ujërave të lumenjve.

Gjithashtu, kreu i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit u shpreh se monitorimi i faunës së egër tregon rezultatet pozitive të zbatimit të moratoriumit të guetisë, ku thuhet të gjitha speciet e monitoruara kanë pësuar rritje gjatë këtyre dy viteve



VENDIMET E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS SHKURT 2016

Nr.	Subjekti	Aktiviteti	Vendodhja	Vendimi
1	ALENA ALB	VP Depozita sipërfaqësore të gazit natyror	Cërrik, Elbasan	Vendim për VNM Paraprake
2	KOKA	VP Zgjerim sipërfaqe shfrytëzimi kromi	Thekën, Bulqizë	Vendim për VNM Paraprake
3	PEZA	VP Godinë banimi dhe shërbimi	Tiranë	Vendim për VNM Paraprake
4	ROZAF	VP Fabrikë për prodhimin e ushqimeve me bazë peshku & vajrave të peshkut	Labinot, Fushë Elbasan	Vendim për VNM Paraprake
5	Stone Marble Volona	VTH Shfrytëzim mineral ranor silicor	Kuç, Vlorë	Deklaratë Mjedisore

Nr.	Subjekti	Aktiviteti	Vendodhja	Hartoi Dosjen	Vendimi
1	Age Kuç	VP Hec	Kuç, Vlorë	L. Vllamasi	Plotësim Informacioni
2	Atean 846	VP Shfrytëzim kromi, galeri	Bulqizë, Dibër	R. Pupli	Plotësim Informacioni
3	Atean 847	VP Shfrytëzim kromi, galeri	Bulqizë, Dibër		
4	Denim Factory	VP Fasoneri	Durrës	B. Saraçi	Vendim për VNM Paraprake
5	Elit Gas	VP 5 Depozita sipërfaqësore të gazit natyror	Shëngjin, Lezhë	I. Robo	Vendim për VNM Paraprake
6	Eurobiznes	VP Ndërtim Hidrocentrali 1,2 & 3 (2MË)	Kukës	N. Marku	Vendim për VNM të thelluar
7	Hydropoëer panarit	VP Hidrocentrali Vile	Korçë	F. Kurteshi	Plotësim Informacioni
8	IMS group	VP Përpunim i peshkut & zorrëve të kafshëve (gjedh, derr, kalë, etj.)	Lezhë	Studio ECO	Vendim për VNM Paraprake
9	Loci	VP Godinë ndërtimi 8K+ 1K nëntokë	Fushë Krujë, Durrës	A. Muha	Vendim për VNM Paraprake
10	Marlindi XH-2014	VTH Shfrytëzim kromi	Kukës	H. Doçi	Deklaratë Mjedisore

LEJET MJEDISORE MARS 2016

NR	SUBJEKTI	AKTIVITETI	VENDNDODHJA	VENDIMI	TIPI I LEJES
1.	Xhulio LC 8174	Prodhim i produkteve abrazive dhe produkteve të tjera minerale jo metalike	Karmë, Shkodër	Miratim	Tipi B
2.	Xhulio LC 8678	Prodhimi i produkteve abrazive dhe produkteve të tjera minerale, jo metalike	Kavajë, Tiranë	Miratim	Tipi B
3.	Romano Port	Rishikim. Magazinim naftë dhe nënprodukteve të saja në cisterna të palëvizëshme në një terminal	Porto Romano, Durrës	Miratim	Tipi B
4.	Kallmeti	Prodhim i alkolit dhe pijeve alkalike duke përfshirë dhe fabrikat e birrës	Leshë	Miratim	Tipi B
5.	Canameti	Minierat nëntokësore dhe veprimtari të lidhura me to	Krastë, Dibër	Miratim	Tipi B
6.	Trema Lc 8624	Përzjerja e çimentos ose prodhim i çimentos në masë të madhe dhe prodhim i produkteve abrazive dhe produkteve të tjera minerale jo metalike	Mat, Dibër	Miratim	Tipi B
7.	Trema Lc 8626	Përzjerja e çimentos ose prodhim i çimentos në masë të madhe	Mat, Dibër	Miratim	Tipi B
8.	Balla -SK	Prodhim i produkteve abrazive dhe produkteve të tjera minerale jo metalike	Rrashbull, Durrës	Miratim	Tipi B
8.	Prima Gas	Gaz natyror aromatik ose GNL përveç rasteve kur veprimtaria është e lidhur me tipin A ose përzjerje e aromave	Portëz, Fier	Miratim	Tipi B
9.	Albdrilling Green	Asgjësimi i mbetjeve të rrezikshme përveç incinerimit (5.1 a) ose landfillimit (5.2 a)	Patos, Rusinjë, Fier	Miratim	Tipi B
10	Mare-Oil	Transferim A1 - Gaz 2015 Gaz natyror aromatik ose GNL, përveç rasteve kur veprimtaria është e lidhur me tipin A ose përzjerje e aromave	Katund i Ri	Miratim	Tipi B
11.	Trans Oil Group	III-2B Mbetje të dala nga rafinerimi i naftës nga pastrimi i gazit dhe nga trajtime periodike të karbonit	Portëz, Fier	Miratim	Tipi B
12.	INFINIT CONSTRUCTIONS	III.2.B Grumbullim, transportim, ruajtje të mbetjeve urbane	Tiranë	Miratim	Tipi B
13.	Tris Alb	Rritje intensive e gjedhit në një instalim	Libofshë, Fier	Miratim	Tipi B
14.	ITALCOL	Rishikim. Prodhimi i produkteve abrazive dhe produkteve të tjera minerale jo metalike. Prodhimi i bojave, preparateve, llaqeve	Tiranë, Fushë Prezë	Miratim	Tipi B
15.	HAJG	Rritje intensive e shpendëve në një instalim	Flakë, Durrës	Miratim	Tipi B
16.	ALBA CO	Minierat nëntokësore dhe veprimtari të lidhura me to	Bulqizë Dibër	Miratim	Tipi B
17.	LIALB GAZ ENERGY	Gaz natyror aromatik GNL	Elbasan	Miratim	Tipi B
18.	AGRO BLEND	Magazinimi i kimikateve	Vorë, Tiranë	Miratim	Tipi B

KRJIHET "ROJA E GJELBËR"

Më propozim të ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave miratoi VKM nr. 215, datë 16.03.2015, "Për krijimin e Task-Forcës "Roja e Gjelbër" për marrjen e masave emergjente mbrojtëse për parandalimin, pakësimin dhe riaftësimin nga çdo dëmtim të pyjeve publike e private".

Kjo strukturë e përkohshme operationale vjen pas miratimit të moratoriumit 10 vjeçar për mbrojtjen e pyjeve dhe kryesohet nga zëvendës ministri i Mjedisit z. Kledi Xhaxhiu. Grupi drejtues i Task Forcës "Roja e Gjelbër" ka në përbërje edhe zëvendësministrin e Mbrojtjes, zëvendësministrin e Punëve të Brendshme, zëvendësministrin e Financave dhe prefektët e qarqeve.


Kjo Roje ka, gjithashtu, në përbërje edhe përfaqësues të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, të Drejtorisë së Policisë së Shtetit, të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Më 30 mars 2016, në Ministrinë e Mjedisit u zhvillua mbledhja e parë e Task Forcës, e kryesuar nga zëvendës ministri i Mjedisit, z. Xhaxhiu. Anëtarët e ndryshëm të kësaj Task Force diskutuan gjerësisht për modalitetet e organizimit të punës, përgatitjen e Planit të Veprimit, bashkërendimin mes të gjitha strukturave të përfshira në këtë Task Force, në nivel qendror dhe vendor, krijimin dhe organizimin e Grupeve të Kontrollit, hartën e Pikave të Kontrollit dhe çështje të tjera të karakterit logjistik, me

qëllim zbatimin më së miri të detyrave, që Vendimi i Këshillit të Ministrave i ka caktuar kësaj strukture të përkohshme operationale.

Task Forca do të veprojë në nivel rajonal pranë drejtorive vendore të Policisë së Shtetit, ndërsa do të kryesohet nga nëndrejtori i policisë.

Tre janë detyrat kryesore të kësaj strukture operationale, ajo e monitorimit, mbikëqyrjes dhe patrullimit e rajoneve pyjore të vendit, dhe vëzhgimin e bizneseve që kryejnë tregti drusore, parandalimin dhe ndalimin e çdo personi që shkel ligjin e moratoriumit, si dhe organizimin e pikave të kontrollit në nyjet kryesore ku transportohen lëndë drusore.



“Të gjithë duan të ndryshojnë botën, por askush nuk dëshiron të ndryshojë veten”.

Leon Tolstoi

SEKTORI I TRANSPARENCËS DHE KOMUNIKIMIT
Email: info@moe.gov.al

NGA AKTIVITETET E ORGANIZATAVE MJEDISORE

MJEDISI I SHËNDËTSHËM PËR NJË EDUKIM CILËSOR

Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) Shqipëri dhe Qendra EDEN, në mjediset e hotel Tirana International zhvilluan aktivitet në kuadër të edukimit mjedisor me fokus “Mjedis i shëndetshëm për një edukim cilësor”. Ky aktivitet u zhvillua me pjesëmarrjen e drejtorëve të shkollave 9-vjeçare të Tiranës; mësuesve të klasave të 4-ta; përfaqësuesve të organizatave që punojnë në Edukim dhe Mjedis; përfaqësuesve nga Ministria e Mjedisit, Bashkia Tiranë dhe DAR Tirana. Ky aktivitet kishte si qëllim diskutimin e sfidave dhe mundësive për bashkëpunim për një mjedis të shëndetshëm dhe një edukim cilësor për brezin e ri.

Edukimi, përveç se është një prej të drejtave të njeriut, është një kusht paraprak për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm dhe një mjet kryesor për një qeverisje të mirë, informimin rreth vendimmarrjes dhe mbështetjen e demokracisë.

Prezantimet e paraqitura në aktivitet, si dhe diskutimet më pas nga pjesëmarrësit, ishin të fokusuar në çështjet për të patur një mjedis të shëndetshëm dhe një edukim cilësor përmes:

- 1. Zbatimit të modeleve dhe praktikave të mira të futura tashmë në të gjitha nivelet dhe profilet e shkollës;
- 2. Zhvillimit të Edukimit Mjedisor si edukim novator, një formë e re kjo e edukimit sot larg edukimit tradicional brenda klasës;
- 3. Përfshirjes së shkollës në bashkëpunim me komunitetin, ku roli i OJF-ve është i pazëvendësueshëm në rritjen e ndërgjegjes së komuniteteve në veprime konkrete në përmirësim të gjendjes së mjedisit.

Në arsimin 9-vjeçar ka disa module që trajtojnë edukimin për mjedisin, të zhvilluara me asistencën e huaj (si Paketa e Gjellbër nga Qendra Rajonale e Mjedisit; CLEEN nga UNICEF, etj) të cilat prej disa vitesh përdoren nga shkollat si kurrikula me zgjedhje.

Ministria e Mjedisit në kuadër të edukimit mjedisor ka hartuar dhe një Program Kombëtar për Edukimin Mjedisor për shkollat 9 vjeçare, program i cili është miratuar edhe nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve.

Në mbështetje të këtij Programi Kombëtar gdo Drejtori Arsimore Rajonale ka përcaktuar dhe koordinatorin për problemet mjedisore. Pritet që shkollat të hartojnë një manual për veprimtaritë që do zhvillojnë në kuadër të aktiviteteve që vetë shkolla do të ndërmarë për të qënë më pranë mjedisit.

Në Shqipëri nuk janë vetëm institucionet shtetërore që

kanë në fokus përfshirjen sa më të madhe të edukimit mjedisor brenda shkollave, por janë dhe organizatat jofitimprurëse. Shumë organizata jofitimprurëse realizojnë aktivite edukuese me shkollat, falë mbështetjes së huaj në vend.

Një nga aktivitetet e fundit ka qënë dhe realizimi i Paketës së Ajrit 2016, i cili u prezantua në këtë takim dhe ishte paketë e mundësuar nga Qendra Rajonale e Mjedisit (REC), si pjesë e punës për të krijuar modele dhe praktika të reja për një mjedis të shëndetshëm dhe një edukim cilësor për brezat e ardhshëm.

Për të pranishmit në fund të takimit u shpërndanë (i) Paketa e Gjellbër; (ii) Paketa e Ajrit; (iii) Edukimi Mjedisor si projekt “Shkolla si qendër komunitare”.

NISMA TË PASTROJMË LUMENJTË PRANË QYTETIT TONË

Një nismë interesante nga Natura 2000, IUCN, ADZM, PPNEA, u prezantua më 11 Mars në qytetin e Elbasanit për pastrimin e lumit Shkumbin nga inertet dhe hedhjet e mbeturinave plastike.

Aktiviteti kishte pjesëmarrje të qytetarëve dhe nga institucionet publike. Po kështu, në këtë aktivitet ishin pjesëmarrës dhe stafi drejtues dhe administrata e Zonave të Mbrojtura në këtë qytet, të cilët ishin dhe protagonistët në organizimin dhe zhvillimin e nismës për një lumë më të pastër. Shkumbini është një lumë që bëhet tepër i rrëmbyeshëm në periudha shirash dhe përmyt toka bujqësore dhe banesa pranë tij. Në këtë tejfryrje të lumit, ndikojnë shumë dhe inertet dhe mbeturinat që hidhen në të.

Kjo nismë u mbështet dhe nga qytetarët, të cilëve u bë thirrje që kjo të kthehet në një aksion periodik për pastrimin e shtrateve të lumenjve, pasi uji në të duhet të jetë i rrjedhshëm e pa pengesa prej faktorit njerëzor.

AKZM dhe Natura 2000 me rastin e Ditës Botërore të Veprimit në Lumenj ftuan fëmijët të ngjyrosin figura me masazhe për mbajtjen pastër të natyrës dhe veçanërisht të lumenjve. AKZM ishte e pranishme me një stendë në Sheshin Nënë Tereza, të ngritura nga Bashkia, me rastin e Ditës së Verës.

Në ditët në vazhdim AKZM dhe Natyra 2000 do të vazhdojnë pastrimin e lumit Shkumbin në bashkëpunim me nxënësit e shkollave, komunitetin, shoqërinë civile dhe bashkitë përkatëse.

BASHKIA TROPOJË TAKIM ME NXËNËSIT PËR PROBLEMET MJEDISORE
Krerët e Bashkisë Tropojë pritën nxënësit të disa shkollave të rrethit të Tropojës të iniciuar nga përfaqësues të shoqatës Alpin. Arsyja e vizitës së këtyre nxënësve ishte të paraqesin shqetësimet e tyre për mjedisin që ata i rrethon. Me çiltërsinë e tyre, fëmijët pohuan se janë njerëzit ata që duhet të jenë më të përgjegjshëm ndaj dëmeve të mëdha që i sjellin Tokës, duke e ndotur dhe duke mos treguar kujdesin e duhur ndaj saj.

“Njerëzit duhet të jenë më të kujdesshëm që të mos jenë faktori i qëllimshëm në ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës, pasi kështu shkatërojmë veten tonë” – pohuan ata. Pyetjet e drejtuara panelit ishin të ndryshme nga të gjithë të pranishmit me idenë dhe bindjen e plotë që “Ne kemi të drejtë të jetojmë gjelbër”.

Nënkryetarja dhe përfaqësuesit e bashkisë falenderuan nxënësit për këtë iniciativë aq të madh në vetvetë, sa është mjedisi.

Ata u shprehën se “është një moment i shkëlqyer që ju jeni sot në ambjentet e Bashkisë Tropojë për të biseduar dhe shprehur shqetësimet që kanë të bëjnë me mjedisin, pasi ne jemi këtu jo vetëm për të dëgjuar mbi problematikat që ju keni, por dhe për të marrë përgjegjësi për të ardhmen”.



TRAJNIM PËR MBROJTJEN E NATYRËS



REC Shqipëri – U zhvillua në Shkodër trajnimi “Mbrojtja e Natyrës - Sfidat e arrihtës së Standardeve Evropiane”.

Në këtë takim merrnin pjesë përfaqësues të shoqërisë civile, Qendra e Aarhusit Shkodër, ekspertë mjedisorë, dhe përfaqësues të Agjencive Rajonale të Zonave të Mbrojtura në zonën e Shkodrës. Të pranishmit pasi u njohën me pjesën teorike të trajnimit patën dhe një vizitë në terren dhe pikërisht në zonën e Kelmendit. Ky aktivitet u mundësua në kuadër të projektit ACHIEVE.

Në këtë zonë u diskutua me pjesëmarrësit, rëndësia e ruajtjes së biodiversitetit dhe integrimi i vlerave të natyrës me turizmin e qëndrueshëm malor.

Gjatë këtij itinerari u krye dhe një vizitë përgjatë lumit të Cemit, që veç vlerave të biodiversitetit është edhe një lum i përbashkët i Shqipërisë me Malin e Zi.